



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2962/2 prot.,

Datë 01.12.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur*” me mjete elektronike” me nr. REF-77341-08-11-2023 me objekt: “*Shërbim për monitorimin e mjedisit*”, me fond limit 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 07.11.2023 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a..
- Ankimues:** “TENUIS LABORATORIES” SHPK me NIPT L81904506I dhe me adresë, Rruga dytësore Maminas-Vorë, Nr 20/38, Koxhas.
- Autoriteti Kontraktor:** Albpetrol sh.a. me adresë Lagjja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Në datën 29.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3650 dhe protokolluar me nr. 2962/2023 prot., datë 30.11.2023 e operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “TENUIS LABORATORIES” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

- OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar emrat e personit (personave) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, të cilët nuk janë ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së, konkretisht për ortakun P.M. (referuar ekstraktit historik të OE). Kjo në kundërshtim me kërkesat e gërmës “ç” të pikës “1” “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”, të shtojcës 8 të DST-së.

- OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në deklaratën “A” “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës” emrat e punonjësve të stafit teknik paralel me profesionin të cilit i përkasin. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. dhe 2.3.4 të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8 të DST-së.

- OE nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të konfirmuar nga administrata tatimore. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.1. të pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST-së.

- OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në këtë shtojcë disponimin e një Laboratori të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, të paktën 1(një), për monitorimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave të referencës, i cili të jetë në pronësi ose me qira. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.9. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8 të DST-së.

Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues “TENUIS LABORATORIES” SHPK kërkon anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, si dhe qartësimin e numrit të mostrave të ujit sipërfaqësor, tenkologjik dhe në kanalizime dhe pikave të monitorimit të ajrit, zhurmës dhe vibrimeve sepse ndikojnë drejtpërdrejt në ofertën ekonomike.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.12.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar

Fiorent Zguro

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri